

Aplikanti:  
Dritrit Voci

Nr. 87. Prato

## VENDIM

NR 7 DATE 30.06.2014

I

### “ASAMBLESE SE PERGJITHESHME TE ORTAKEVE” TE SHOQERISE “GO TECH “SHPK

Sot, ne daten 30/06/2014, u mblodh “Asambleja e Pergjitheshme e Ortakeve” e shoqerise “GO TECH” Sh.p.k, shoqeri e themeluar konform Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare”, i ndryshuar rregjistruar ne Q.K.Rr me numer NIPTI-i K91307509G.

Ortaket e shoqerise:

- Armand Duka (Zoterues aktiv i 40% te pjeseve te kapitalit)
- Agron Duka (Zoterues pasiv i 40% te pjeseve te kapitali)
- Bujar Cepeli (Zoterues aktiv i 20% te pjeseve te kapitalit)

Mbledhja e “Asamblese se Pergjitheshme te Ortakeve” u zhvillua, ne seline e shoqerise Lagjja Nr 14 ,Rr“Tirana” prane Kompleksit AIBA ,Shkozet-Durres “

Te pranishem ne mbledhje ishin ortaket qe zoterojne 100% te kapitalit.


- 1- Armand Duka (ortak) i cili zoteron 40% te pjeseve te kapitalit si dhe administrues i 40% te kuotave te Ortakut pasiv te z. Agron Duka, ne cilesine e njeriut te besuar.
- 2- Bujar Cepeli (ortak) i cili zoteron 20% te pjeseve te kapitalit

Rendi i dites eshte:

- Shqyrtimi dhe miratimi i Pasqyrave Financiare te vitit ushtrimor 2013.
- Destinimi i fitimit neto, te vitit ushtrimor 2013
- Caktimin e Ekspertit Kontabel te te Rregjistruar 2014 per auditimin e pasqyrave financiare te vitit 2014.

Pasi u lexua raporti i drejtimit nga Z. Bujar Cepeli dhe raporti i E.K.Rregjistruar Zj. Vera Lala, per “Pasqyrat Financiare dhe shenimet anekse” te shoqerise per vitin 2013, mbeshetur ne Statutin e shoqerise “GO TECH” SH.P.K, ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare” neni 81 germa “e”, dhe ne respektim te ligjit Nr 9920 dt 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne RSH”, dhe Ligjit 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, “Asambleja e Pergjitheshme e Ortakeve” pas shqyrtimit te çdo pike te rendit te dites:

VENDOSI:



1-Te miratojë "Pasqyrat Financiare" te shoqërisë "GO TECH" sh.p.k per vitin 2013 dhe rezultatin (fitimin neto) sipas tij me vlerë 15,049,294 (pesëmbëdhjetë milion e dyzetë e nente mijë e dyqind e nentëdhjetë e kater) leke

2-Fitimi neto, (pas zbritjes së tatimit fitimit), i shoqërisë "GO TECH" sh.p.k per vitin 2013, Eshtë: 15,049,294 leke (pesëmbëdhjetë milion e dyzetë e nente mijë e dyqind e nentëdhjetë kater) leke.

3- Fitimi neto i shoqërisë per vitin 2013 me vlerën **15,049,294 leke**, te kalojë per:

➤ Zmadhim të Kapitalit Themeltar të shoqërisë .

4-Te emerojë Zj.Vera Lala, eksperte Kontabel i Regjistruar ,per te hartuar raportin per zmadhimin e kapitalit ,me perfshirjen e fitimit neto te vitit 2013.

5-Te emerojë Shoqërine audituese „Venis-Audit & Finance „shpk ,me NIPT L12005002L perfaqesuar nga Zj.Vera Lala ,Ekspert Kontabel i Regjistruar,me licensce profesionale nr.135,date 27.02.2005,per auditimin e pasqyrave financiare te vitit 2014.Autorizohet administratori i shoqërisë Z.Bujar Cepeli per te nenshkruar marreveshjen e auditimit dhe per te negociuar tarifen e ketij sherbimi.


6-Ngarkohet administratori i shoqërisë ,apo nje person i autorizuar prej tij ,per te depozituar pranë Q.K.R-se dhe administrates tatimore kete vendim.

#### ASAMBLEJA E PERGJITHESHME E ORTAKEVE

Armand DUKA



Bujar CEPELI



Agron DUKA

Person i besuar nga Pronari  
Armand DUKA



Aplikant:  
Dritrit Voci

Nr. 88 Prot

## VENDIM

NR. 8 DATE 12/07/2014  
"ASAMBLESE SE PERGJITHESHME TE ORTAKEVE"  
TE SHOQERISE "GOTECH" SHPK

Sot, ne daten 10/07/2014, u mbledh "Asambleja e Pergjitheshme e Ortakeve" e shoqerise "GOTECH" Sh.p.k, shoqeri e themeluar konform Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare", rregjistruar ne Q.K.Rr me numer NIPTI-i K91307509G.

Ortaket e shoqerise:

- Armand Duka (Zoterues aktiv i 40% te pjeseve te kapitalit) dhe administrues i 40% te pjeseve te kapitalit te z.Agron Duka.
- Agron Duka (Zoterues pasiv i 40% te pjeseve te kapitalit)
- Bujar Cepeli (Zoterues aktiv 20% te pjeseve te kapitalit).

Mbledhja e "Asamblese se Pergjitheshme te Ortakeve" u zhvillua, ne seline e shoqerise Lagjja Nr 14 ,Rr" Tirana" prane Kompleksit AIBA ,Shkozet-Durres "

Te pranishem ne mbledhje jane:

1. Armand Duka, ne cilesine e "ortakut aktiv"(zoterues i 40% te kuotave te kapitalit) si dhe administrues i 40% te kuotave te "Ortakut pasiv Z.Agron Duka, me cilesine e "Njeriut te besuar"
2. Z. Bujar Cepeli, ne cilesine e oratakut aktiv (zoterues i 20% te kuotave te kapitalit)
3. Zj. Vera Lala, E.K.Rr

Pjesmarja lejon vendim marjen ne perputhje me Statutin e Shoqerise dhe Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare".

Rendi i dites eshte:

- Shqyrtimin e "Raportit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar per dhenien e sigurise per vleresimin e Zmadhimit e Kapitalit Themeltar te Shoqerise, nga fitimi i shoqerise, gjendje me 31,12,2013.
- Zmadhimi i kapitalit te shoqerise nga fitimi i shoqerise, gjendje me 31,12,2013 .

Per sa me sipër "Asambleja e Pergjitheshme e Ortakeve ":

VENDOSI:

1. Miratimin e "Raportit të Ekspertit Kontabel të Regjistruar për dhenien e sigurisë për vlerësimin e Zmadhimit të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, nga fitimi i shoqërisë, gjendje me 31.12.2013 me vlerë 15,049,294 leke (pesëmbëdhjetë milion e dyzetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) leke
2. Të miratojë Zmadhimit të Kapitalit Themeltar, "nga fitimi i vitit 2013" sipas bilancit të shoqërisë të datës 31.12.2013 si më poshtë:
  - Kapitali i Nenshkruar që zotërohet nga "Ortaket":
    - Z. Armand Duka (ortak aktiv) i cili zotëron 40% të pjesëve të kapitalit.
    - Z. Agron Duka (ortak pasiv) i cili zotëron 40% të pjesëve të kapitalit.
    - Z. Bujar Cepeli (ortak aktiv) i cili zotëron 20% të pjesëve të kapitalit.

Ishte :42,355,314 leke (dyzetëdhjetë milionë treqind e tridhjetë pesë mijë e treqind e katër mbëdhjetë leke)

Behet: 57,404,608 leke (pesëdhjetë e shtatë milionë katërqind e katër mijë e gjashtë qind e tetë leke)

Numri i pjesëve 100

Vlera nominale e një pjesë 574045.8 leke;


Perqindja e pjesëmarrjes së ortakëve në kapital nuk ndryshon.

3. Ngarkohet drejtimi, për depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombëtare të Rregjistrimit, bashkë me raportin e EKRr, për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit.

**ASAMBLEJA E PERGJITHESHME E ORTAKEVE**

**ORTAKET**

**Armand DUKA**



**Bujar CEPELI**



**Agron DUKA**

Person i besuar nga Pronari  
**Armand DUKA**

